



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 2294 Prot.

Tiranë, më 28.07.2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1031/7, DATË 30.06.2025 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI BARDHYL GJYZELI NDAJ ISH-MAGJISTRATIT T.S. DHE ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS NDAJ MAGJISTRATES E.GJ”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Bardhyl Gjyzeli nr. 1908 prot., datë 05.06.2023, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë hetimore të prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe veprimtarisë gjyqësore të magjistrates znj. E.Gj., gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, dhe me vendimin 1031/7, datë 30.06.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar të ankesës së paraqitur nga shtetasi Bardhyl Gjyzeli ndaj ish-magjistratit T.S. dhe arkivimin pas verifikimit të ankesës ndaj magjistrates E.Gj”, bazuar në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur përfundimin e procedurës pa një vendim përfundimtar dhe arkivimin pas verifikimit të ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Berat.
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko